



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2021

**VENDIM**  
**Nr. 210, datë 20.05.2021**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Altin Abdiu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; I pandehur: {...}; Objekti: Rigjykim i çështjes penale për të pandehurin {...}, akuzuar për veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, etj.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Besnik Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin; I pandehur: {...}; Objekti: Neni 283/2 i Kodit Penal.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështjen civile me Paditës: Shoqëria Kursim Kredi “Pinare”; I paditur: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Objekti: Pavlefshmëri akti, sigurim padie.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik” Neni 236/2 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Enkeleda Dalipi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Vjedhje e mbetur në tentativë.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Akuza: Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SARANDË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, Marjola Beluli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me Objekt: Gjykimin e të pandehurit {...} akuzuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve i mbetur në tentativë”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Mirela Kore (Iliopulli), caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen gjyqësore me Viktimë akuzuese: {...}; I akuzuar: {...}; Objekti: “Gjykimi i të akuzuarit për veprat penale të “Fyerjes”, “Shpifjes” dhe shpërblim dëmi”.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Besnik Shehu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec etj.; I pandehur: {...}; Akuza: Për kryerjen e veprës penale “Vjedhje me dhunë” parashikuar nga neni 139 të Kodit Penal.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Artur Prenga, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen civile me palë paditëse: {...}; Të paditur: {...}, {...}, {...}; Objekti: Shpërblim dëmi.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Luljeta Kolonja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, çështjen gjyqësore me Kërkuese: {...}; Objekti: Rishkim vendimi.

## **GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË**

1. Gjyqtaret e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Ersida Bajgora dhe Miranda Nakaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 139 i Kodit Penal.

## **GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË VLORË**

1. Gjyqtarja e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, Ema Shaholli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, çështjen civile me: Paditës: {...} {...}{...}j, {...}; I paditur: {...}, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë; Objekti: “Detyrimin e të paditurit për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si rezultat i mos zhvillimit të disa proceseve, duke vendosur gjoba të jashtëligjshme dhe të parregullta në dëmin tonë”.

## **GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, Genti Dokollari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Nenet 283/1, 333/a/1, 334 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Petrit Çomo si dhe gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ilir Përdeda, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; Të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Nenet 283/a/1 e 22, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

## **GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Shkodër, Fuat Vjerdha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Trafikim i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a-22 i Kodit Penal.

## **GJYKATA E APELIT KORÇË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Artur Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Viktima: {...}, {...}; Akuza: Dhunë në familje.

2. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr. 530 prot., datë 14.05.2021, të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Ersil Rumi; objekti: “Zëvendësim i masës mjekësore “Shtrim i përkohshëm në institucion mjekësor psikiatrik” të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr. (409) prot., datë 17.12.2020, duke caktuar masën mjekësore atë të “Mjekimit të detyruar ambulator” për shtetasin {...}.

## **GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Laurent Fuçia, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Vjedhje”.

2. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Engert Pëllumbi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Vjedhje e kryer duke shpërdoruar detyrën.

## **GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi pasuror”.

2. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: OST Tiranë; Objekti: “Zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënies në punë”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Ndryshim vendimi”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Ndryshim i pjesëm të vendimit”.

5. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja dhe Valbon Çekrezi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj; I paditur: OST Tirane, etj; Objekti: Detyrim page.

6. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; I paditur: {...}, etj; Objekti: Ndryshim vendimi.

7. Gjyqtaret e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici dhe Igerta Hysi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}, etj; I paditur: {...}; Objekti: Shpërblim dëmi.

8. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...} etj; Akuza: Nenet 189-25, 278/1 të Kodit Penal.

9. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...} Objekti: Neni 278/2, 79/dh-22 të Kodit Penal.

10. Gjyqtarja e skemës së delegimit e caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 88/1 dhe 278/1 të Kodit Penal.

### **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Sokol Pina dhe Miranda Andoni, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 186/3 i Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**